



Viti i VII-të i Botimit, Nr.1,
Qershorë 2016

EFEKTET E PANDERSHMËRISË AKADEMIKE TEK STUDENTËT

Drilona Llangos

Universiteti Tiranës, Departamenti Psikologji-Pedagogji

Adresë kontakti: drilonallangos@gmail.com

Përmbledhje

Pandershmëria akademike e studentëve është një fenomen botëror, nga i cili nuk “shpëton” dhe sistemi ynë arsimor, por ndërsa rastet nga bota publikohen dhe për to merren masa ndëshkuese konkrete, në shkollat tona dëgjojmë përditë raste të kopjimit apo formave të tjera të pandershmërisë akademike dhe shumë pak masa ndëshkuese janë ndërmarrë. Ky studim tenton të zbulojë efektet që ka pandershmëria akademike në formimin e personalitetit të studentit.

Pyetje kërkimore të ngritura janë: A ndikon pandershmëria akademike në formimin e personalitetin të studentit? A bëhet më “dembel” studenti që përfiton nga pandershmëria akademike?

Hulumtimi i literaturës është pjesë e rëndësishme e metodologjisë, pasi do të ndihmojë në mbështetjen teorike të studimit dhe për të plotësuar më mirë qëllimin e tij. Ndërkohë, rezultoni paraprakisht nisur nga hulumtimi i literaturës që ka një ndikim të pandershmërisë akademike dhe në formimin e personalitetit të studentit.

Fjalë çelës: pandershmëri akademike, plagjiaturë, personalitet, performancë, edukim.

THE EFFECTS OF ACADEMIC DISHONESTY TO THE STUDENTS

Abstract

The academic dishonesty of students is a global phenomenon and also happens in our educational system, but about the cases published from around the world have been taken punitive measures, in our schools we hear every day about copying or other forms of academic dishonesty and few punitive measures have been taken. This study aims to reveal the effects that academic dishonesty has in the formation of the student's personality.

Research questions are: Does the academic dishonesty affect the formation of the student's personality? Will students become more “lazy” as they benefit from the academic dishonesty?

Review of literature is an important part of the methodology because it will support the

theoretical study to better fulfil its purpose. Meanwhile, results from an advance review of literature support the idea that academic dishonesty has an impact in the formation of the student's personality.

Key word: academic dishonesty, plagiarism, personality, performance, education.

Hyrje

Gazeta Tema 2 shkurt 2013, *Skandal në Harvard, dhjetëra studentë përjashtohen pasi kanë kopjuar në teste. Një skandal i pazakontë ka tronditur një ndër institucionet arsimore me prestigjioze në botë, Universiteti i Harvardit i cili ka njoftuar se ka imponuar sanksione akademike për dhjetëra studentë që kanë mashtruar në një provim përfundimtar. Dekani shtoi se një komision i brendshëm do të verë përpara rekomandime se si të promovohet ndershmëria brenda institucionit. “Kjo është një kohë për reflektim dhe veprim”, - tha zoti Smith. Ne jemi përgjegjës për krijimin e komunitetit në të cilën studentët studiojnë.*

Rasti i mësipërm tregon qartë që pandershmëria akademike e studentëve është një fenomen botëror, nga i cili nuk shpëton dhe sistemi ynë arsimor, por ndërsa rastet nga bota publikohen dhe për të merren masa ndëshkuese konkrete, në shkollat tona dëgjojmë përditë raste të kopjimit apo formave të tjera të pandershmërisë akademike dhe shumë pak masa ndëshkuese janë ndërmarrë. Ky studim tenton të zbulojë efektet që ka pandershmëria akademike në formimin e personalitetit të studentit. Por kur flasim për personalitetin e dikujt, ne flasim për atë çka e bën këtë individ të ndryshëm nga njerëzit e tjerë, madje unik. Në studimin e personalitetit ekzistojnë shumë teori. Humanistët dhe ekzistencialistët priren të përqendrohen në pjesën e kuptueshme. Ata besojnë se shumë prej asaj që ne jemi, është gjendje shumë komplekse dhe përqendrohen në histori dhe kulturë “për të parashikuar dhe kontrolluar”. Veç kësaj, ata sugjerojnë se “të parashikosh dhe të kontrollosh” njerëzit, është në një masë të konsiderueshme jo etike. Bihejvioristët dhe frojdianët, nga ana tjetër parapëlqejnë parashikimin dhe kontrollin (1). Duke qëndruar tek behejvioristët mund të shpjegojmë dhe një sërë shfaqjesh të pandershmërisë akademike tek studentët. Ashtu siç modelohen sjelljet pozitive, mund të mësohen edhe ato jo pozitive, ashtu si mësojnë të jenë konkurrues dhe ambiciozë, studenti mund të mësojë të bëhet “kopjac” dhe “mashtrules” për aq kohë sa kjo sjellje është shpërblyese dhe qëndron e pandëshkuar.

Ndërkohë, nëse kthehemi në kohën e fëmijërisë, aty ku mësohen dhe modelohen sjelljet e para, mësohen dhe rregullat morale. Kur fëmijët ndërveprojnë me të tjerët dhe shohin se njerëz të ndryshëm kanë rregulla të ndryshme, ka një ndryshim gradual ndaj një moraliteti bashkëpunimi. Fëmijët fillojnë të kuptojnë se njerëzit i bëjnë rregullat dhe njerëzit mund t'i ndërrojnë ato (8). Dihet se kur rritemi të gjithë vendosim rregulla për sjelljen tonë, e kontrollojmë atë, pasi kemi arritur të mësojmë çfarë sjelljesh shoqëria çmon e vlerëson më tepër dhe çfarë nuk miraton apo i përbuz. Në këtë mënyrë, përmes identifikimeve me prindërit ose me të rriturit të tjerë, ne fitojmë standarde të brendshme të llojeve të ndryshme, duke u mësuar të jetojmë dhe të sillemi sipas tyre (10). Rezulton që vullneti dhe karakteri i njeriut formohet dhe zhvillohet si rezultat i një përvojë të gjatë të jetës dhe edukimit. Edukimi është një punë ndërtuese dhe tiparet e karakterit formohen nën influencën e kushteve shoqërore ku jeton dhe vepron njeriu, i cili është një qenie e edukueshme, e vetedukueshme, e riedukueshme (2). Skineri thoshte se, në vend që të marrim vendimet tona të lira, ne kontrollohemi nga ambienti ynë. Ne jemi produkt i përvojave tona të shkuara dhe ambientit tonë (1).

Metodologjia

Ky punim mbështetet kryesisht në hulumtimin e literaturës. Hulumtimi i literaturës është një pjesë e rëndësishme e metodologjisë, pasi do të ndihmojë në mbështetjen teorike të studimit për të plotësuar edhe më mirë qëllimin e studimit.

Çështje kryesore

1. Një këndvështrim mbi studentët dhe formimit të pandershmërisë akademike

Fenomeni i pandershmërisë akademike ka qenë subjekt i shumë studimeve të autorëve të huaj. Trenholm (2007) thekson se mashtrimi (kopjimi, plagjiatura, keqpërdorimi i identitetit dhe bashkëpunimi jo i përshtatshëm) është sjellja që përfshin parimet etike që dhunojnë integritetin akademik. Mashtrimi është një formë e pandershmërisë akademike dhe studimet reflektojnë një shqetësim të thellë në lidhje me shkeljet në sjelljen etike akademike (9). Ai është një problem institucional dhe shoqëror (7). Ndër to trajtohet plagjiatura, si një ndër format më të hasura të pandershmërisë.

Një prezantim me termin plagjiaturë

Plagjiatura është kopjimi apo parafrazimi i punës së njerëzve të tjerë apo ideve në punën tuaj pa i cituar ato. Të gjitha materialet e botuara dhe të pabotuara, qoftë në dorëshkrim, të shtypura apo në formë elektronike, përfshihen nën këtë përkufizim.

Plagjiatura është një shkelje e integritetit akademik. Ky është një parim i ndershmërisë intelektuale që të gjithë anëtarët e komunitetit akademik duhet të pranojnë borxhin e tyre për ideatorët e ideve, fjalëve të cilat formojnë bazën për punën e tyre. Kalimi punës së tjetrit si punën tuaj do të thotë që ju keni dështuar për të përfunduar procesin e të mësuarit (12). Larkham and Manns (2002) theksojnë që shpesh mashtrimi identifikohet si plagjiaturë. Shpesh herë nga të gjitha sjelljet mashtruese, plagjiarizmi shikohet si burim i veçantë konfuzioni (7). Ndërkohë plagjiatura e qëllimshme është jo etike dhe mund të ketë pasoja serioze për karrierën tuaj të ardhshme; ajo gjithashtu minon standardet e institucionit dhe të diplomave që ai lëshon (12).

Clement (2001) e kategorizoi plagjiaturën në tre modele (fshehja e burimit, burimi pa një numër të saktë të faqeve, si dhe kopja dhe ngjitja). Park (2003) përcaktoi se plagjiarizmi mbulon një qëllim të madh në akademi dhe ndodh në forma të ndryshme. Bashkëpunimi midis studentëve që punojnë bashkë, studentët kopjojnë punën e njerëzve të tjerë, pa njohjen e duhur të burimit origjinal dhe studentët e masterit dhe doktoratës falsifikojnë punimet për tezën (7).

Arsyet përse duhet shmangur plagjiatura?

Pandershmëria akademike i kushton institucionit kohë administrative, humbje të integritetit brenda shkollës dhe mungesë të respektit nga studentët për etikën dhe vlerat. Anëtarët e universitetit e shikojnë si dështim të drejtimit dhe menaxhimit të institucionit për të stabilizuar standardet e integritetit (7). Gjithashtu, duhet theksuar që studentët vijnë në universitet për të mësuar të njohin dhe të shprehin mendimet e tyre, jo thjesht për të qenë papagall i mendimeve të të tjerëve. Në fillim mund të duket shumë e vështirë që studentët të zhvillojnë pikëpamjet e tyre. Megjithatë, është e rëndësishme që ata të mësojnë të zhvillojnë zërin e tyre. Si anëtarë të komunitetit të vogël

akademik, studentët duhet të mësojnë se si të lexojnë literaturë akademike dhe si të shkruajnë në një stil të përshtatshëm (12). Studentët nuk duhet të shmangin plagjiaturën nga frika e pasojave disiplinore, por sepse duhet të aspirojnë për të prodhuar një punë të cilësisë më të lartë (5).

Edhe në qoftë se studentët nuk kanë ndërmend të bëhen akademikë, ata duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë gjykimin kritik dhe të shkruajnë në mënyrë të qartë dhe bindëse, aftësi që do t'ju shërbejnë për jetën dhe që çdo punëdhënës do t'i vlerësojë (13). Kelly diskuton një numër të lartë të rasteve të sjelljes së keqe shkencore që kanë dalë gjatë 20 viteve të fundit. Duke vepruar kështu, ai thekson mënyrën në të cilën gjithnjë në rritje presioni për sukses mund, dhe shpesh arrin, të korruptojë procesin e kërkimit. Si rezultat i kësaj, argumenton ai, kërkuesit e diplomuar duhet të përshtaten jo vetëm me normat e sjelljes etike shkencore, por edhe me traditat e reflektimit dhe të vlerësimit që do t'u mundësojë atyre që të njohin dhe për t'i përgjigjen sfidave etike të ngulitura në programet e tyre kërkimore (5). Huamarrja eseve nga studentët e tjerë, duke i përshtatur dhe duke i paraqitur si punë personale, do të pengojë zhvillimin akademik. Ndërkohë, studentët të cilët japin hua ese për këtë qëllim nuk po u bëjnë favore moshatarëve të tyre (13). Southern University Illinois, për shembull, është përpjekur në mënyrë aktive për të formuluar politikën e tij institucionale për trajtimin e plagjiaturës si për studentët vendas, dhe për të huaj. Universiteti e kupton që studentët nga kultura jo perëndimore mund të kenë koncepte të ndryshme të autorësisë dhe pak ose aspak trajnim se si të përdorin burimet, dhe për këtë arsye mund të kenë nevojë për ndihmë shtesë në shmangien e plagjiaturës (12). Mënyra më e mirë për të shmangur plagjiaturën është për të mësuar parimet e praktikës së mirë akademike në fillimet e karrierës universitare. Shmangia plagjiaturës nuk është thjesht një çështje e sigurimit të referencave të sakta, ajo ka lidhje me vendosjen e aftësive akademike për të bërë një punë sa më të mirë (13).

2. Pandershmëria akademike dhe performanca e studentëve

Shfaqja e fenomenit të pandershmërisë akademike ka si qëllim kryesor marrjen e vlerësimit pozitiv të pamerituar. Nxitja e tij lidhet ngushtë jo vetëm me modelet që ofrohen, por edhe me pritshmëritë që kanë të rinjtë për të ardhmen dhe arsimin. Ndërkohë, nga ana e studentëve janë shtuar mënyrat e pandershme për të marrë një notë të pamerituar, si: kopjet, mashtrimet, plagjiaturat, përdorimi i aparateve elektronike, citimi jo i rregullt, kthimi i punës së një personi tjetër si tënden, dhënia e përgjigjeve shokut të klasës, etj. (7). Nëse do të gërmonim në arsyet e përdorimit të këtyre formave, do t'i referoheshim fillimisht një shembulli tipik: p.sh., në qoftë se studenti ngel në provim, ai mendon se kjo ndodhi ngaqë u pengua nga të tjerët. Reagimi në këtë rast ka të ngjarë të jetë zemërimi i individit. Pra, në raste të tilla ndjenjat apo emocionet përcaktohen në një farë mase nga mendimet tona, nga interpretimet subjektive dhe jo nga realiteti objektiv. Edhe pse mund të ngelin në provim ngaqë nuk kanë studiuar, ata ndiejnë inat dhe zemërim duke menduar se faji është i të tjerëve, pra, i pedagogut ose i dikujt tjetër (10).

Nëse i referohemi teorisë kognitive të motivacionit, e cila e vë theksin tek interpretimi i të menduarit dhe të perceptimit, përmes të cilave individit arrin të parashikojë efektet e menjëhershme të një veprimi konkret, si dhe pasojat e pritshme të veprimeve që bën. Kjo teori përpiqet të analizojë mjetet instrumentale, planet mendore të sjelljeve për periudha kohore të pritshme ose të largëta duke kuptuar mënyrën se si mund të rritet forca e motivacionit tek individit, deri në realizimin e një qëllimi final (10). E konkretizuar me shembullin tonë, studenti që ngeli në provim dhe ia "hedh" fajin të tjerëve, do të përvetësojë jo vetëm mendësi të gabuara, por përpara shembujve të gabuar të shokëve të tij do të ketë lëkundje të vlerave të ndershmërisë dhe do të bëhet pre e

fenomenit të pandershmërisë akademike. Ata do të përvetësojnë besime të gabuara mbi përdorimin e mashtrimit, kopjes dhe do t'i shohin si mjete shpërblyese në një lëndë të caktuar. Kjo përvojë tregon që shkollat tona nuk u japin nxënësve forcën e domosdoshme të logjikës së shëndoshë, të vullnetit për të realizuar një punë në mënyrë të ndershme. Përkundrazi, në vend që ta përgatisin për kushtet e jetës që e presin përpara, vështirësitë në tregun e punës, shkolla e privon atë nga cilësitë e nevojshme për të (6).

Nga një studim i realizuar mbi “Rininë Shqiptare”, një fakt që mbështet mungesën e seriozitetit të arsimit të lartë është tendenca e të rinjve (87%) për ta konceptuar të qenit në universitet apo ndjekjen e një shkolle të lartë më shumë në modë dhe që gëzon popullaritet tek të rinjtë. Edhe koha e studimit që të rinjtë shqiptarë shpenzojnë, është mesatarisht 2 orë e 43 minuta në ditë për të mësuar. Në përgjithësi 43,5% e të anketuarve shpenzojnë më pak se dy orë në ditë për të studiuar, 25,7% rreth 2-3 orë në ditë, ndërsa ata që shpenzojnë më shumë se 3 orë në ditë përbëjnë 29,2% të të rinjve (3). Të gjitha këto dukuri tregojnë që rinia është kthyer në një turmë. Vetëm pak prej nesh e dinë se çfarë besojmë tamam - çfarë vlerësojmë tamam - dhe shpesh as që duam ta dimë. Disa veti psikologjike të turmës janë të përbashkëta me individë të veçantë (4). Siç shprehet dhe G. Le Bon në lidhje me fenomenin e turmës, do të jenë individët që e përbëjnë atë, cilado qoftë mënyra e tyre e jetesës, profesionet, karakteri e zhvillimi mendor, vetëm fakti i grumbullimit të tyre në “turmë” mjafton që ata të ndiejnë, mendojnë e veprojnë krejt ndryshe nga sa do të kishte menduar, vepruar apo ndierë secili prej tyre në veçanti (6). Dallimi është një punë e vështirë; ai kërkon kohë dhe energji emocionale dhe është shumë më e lehtë thjesht të ndjekësh turmën (4).

Konkluzionet

Rezulton paraprakisht nisur nga hulumtimi i literaturës që janë shtuar jo vetëm format e shfaqjes së pandershmërisë akademike, por gjithashtu është rritur numri i rasteve të “mashtrimit akademik”. Kjo vjen si rezultat i mungesës së ndëshkimit të rasteve të hasura. gjithashtu, vihet re dhe një mungesë e informacionit për sa i përket këtij fenomeni. Rastet tregojnë se, për aq kohë që mungon ndëshkimi dhe ka një vlerësim të pamerituar për rastet që aplikojnë mashtrimin, ai mund të kthehet në faktor përforcues për një kategori të tjerë studentësh. Kjo provon që është e vërtetë që studentët që përfitojnë nga mashtrimi akademik, bëhen më dembelë. Ndërkohë, për sa i përket personalitetit, vihet re që ka implikime dhe lidhje midis mashtrimit akademik dhe ndryshime të sjelljes, e shoqëruar me ndryshime të vlerave. Mirëpo ndikimi i drejtpërdrejtë te personaliteti është më i vështirë për t'u matur, për aq kohë sa ai përfshin një tërësi sjelljesh dhe qëndrimesh që maten në kontekste të ndryshme. Ndërkohë, shumë filozofë të shquar, duke përfshirë Herber Spenserin, kanë provuar pa ndonjë vështirësi se arsimit nuk e bën njeriun as më të moralshëm, as më të lumtur dhe nuk ndryshon as instinktet e as pasionet e trashëguara, e madje ndonjëherë po që se arsimit është drejtuar keq, sjell më shumë dëm sesa dobi (6).

Referencat

1. Boere, George, Teoritë e Personalitetit, Plejad, Tiranë, 2004, fq. 139
2. Beqja, Hamit, Kë edukojmë si edukojmë, Plejad, Tiranë, 1987, fq. 309
3. Cela, Alba etj., Rinia Shqiptare, Mes besimit për të ardhmen dhe dyshimit për të tashmen, Fondacioni” Friedrich Ebert”, Tirane, 2011, fq. 103-115; 154
4. Carter, Stephen L. Integriteti, Vernon Publishing, Tiranë 2008, fq. 21

5. Jones, Dorothy L. R, Academic Dishonesty, Are more students cheating?, Business Communication Quarterly, Norfolk State University, June 2011, fq. 141-150
6. Le Bon, Gustave, “Psikologjia e Turmave”, Fan Noli, Tiranë, 2010, fq. 146; 195; 200
7. Witherspoon, Michelle & Nancy Maldonado etj., Undergraduates and Academic Dishonesty, International Journal of Business and Social Science, January 2012, Vol. 3 No. 1, fq. 76-79
8. Musai, Bardhyl, Psikologjia e edukimi, Pegi, Tiranë, 1999, fq. 81
9. Thompson, M. Melody & Jonathan W. Wigglesworth. Students and Teachers as Ethical Actors from: Handbook of Distance Education, Routledge, UK, 2012, fq. 405
10. Orhani, Zenel, Motivacioni, Panteon, Tiranë, 2000, fq 57-58
11. O.CFerrell&JohnFraedrich,BusinessEthics,Ethical Decision Making and Cases, Ethics Publisher, Erin Joyner, South-Western, 2013, fq. 5
12. <https://www.ox.ac.uk/students/academic/guidance/skills/plagiarism?wssl=1> Kerkuar (05.03.2015)\